

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA Faton Ismajli

Transformimi i zhanrit në mediet online

PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2020

UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”
FACULTY OF PHILOLOGY

MA Faton Ismajli

Transformation of the genre in online media

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2020

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA Faton Ismajli

Transformimi i zhanrit në mediet online

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori:

Prof. asoc. Bajram Kosumi PhD

Prishtinë, 2020

Rezymeja

Në këtë punim të disertacionit të doktoratës, me titull “*Transformimi i zhanrit në mediet online*”, do t’i trajtojmë pikërisht këto ndryshime apo transformime që janë bërë në zhanrin e gazetarisë në shekullin e ri. Pra, përmes rastit studimor, do të hulumtohen ndryshimet që kanë ndodhur në fushën e gazetarisë, konkretisht në atë që njihet si gazetari e re. Punët në këtë disertacion do të jetë punë origjinale shkencore, të bazuara në teoritë e fundit të shkencës së komunikimit, punë hulumtuese, ku do të prezantohen gjetje konkrete të rastit studimor dhe me përfundime dhe rekomandime konkrete, duke u dhënë përgjigje problemeve të reja, të dala në shkencën e komunikimit dhe të gazetarisë.

Në kapitullin e dytë të këtij studimi të disertacionit të doktoratës, do të trajtohet sfondi teorik, i cili është ndarë në disa fusha shkencore për ta pasqyruar dhe për t’u mbështetur sa më gjerë në llojshmërinë e shkencave të komunikimit dhe të gazetarisë. Pjesa e parë shkencore e sfondit teorik i paraqet teoritë e shtypit, sepse dukei shikuar këto teori, ne do të argumentojmë se në cilën prej tyre mund të analizohen dhe të hulumtohen mediet që janë në objektin e studimit. Natyrisht që në këtë pjesë të parë të kapitullit të sfondit teorik janë prezantuar katër teoritë e shtypit si: teoria autoritare, teoria sovjetike komuniste, teoria e përgjegjësisë sociale dhe teoria libertariane.

Më tutje, tek ky kapitull i sfondit teorik, do t’u jepet rëndësi edhe shkollave të gazetarisë dhe të shkencave të komunikimit. Duke e parë dhe analizuar qasjen e këtyre shkollave, do ta kemi më të qartë se cila nga këto qasje do të jetë me adekuatja në rastin e studimit. Prandaj, në këtë pjesë janë përfshirë disa nga shkollat kryesore të studimit të gazetarisë dhe komunikimit si: qasja e Shkollës e Kolumbias, qasja e Shkollës së Frankfurtit, qasja e Shkollës së Çikagos si dhe qasja e Shkollës së Torontos. Në pjesën e dytë të këtij kapitulli të parë teorik, fokusi do të jetë mbi teoritë e fundit të medieve të reja. Këto teori janë fjala e fundit e studimeve shkencore mbi sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohen mediet dhe përmbajtjet e tyre në raport me kërkesat dhe hapësirat e publikut. Njëri nga faktorët kryesorë që realisht ka ndikuar edhe në ndryshimin e konceptit mediatik dhe të zhvillimeve teorike është teknologjia. Prandaj, një hapësirë e veçantë do t’i kushtohet edhe zhvillimit teknologjik, me fokus avancimit edhe te interneti dhe hapësira që e kanë shfrytëzuar brenda tij mediet, për ta shfrytëzuar, për të shpërndarë dhe për të komunikuar me publikun dhe audiencën. Si shkak i ndryshimeve teknologjike, zhvillimit të internetit dhe krijimit

të medieeve të reja, që shumë teoricienë e shohin këtë si veç fillimin, kanë ndryshuar edhe mënyra e gazetarisë dhe lëvizja e saj nga shtrati tradicional.

Një pjesë e punimit do t'u kushtohet koncepteve të studiuesve të medieeve për ndryshimet dhe për sfidat që ka sjellur në fushën e gazetarisë zhvillimi i internetit. Këtu do të ofrohen statistika nga bota por edhe nga vendi ynë për mediet e reja, rrjetet sociale, hapësirën virtuale që është në shërbim të audiencës dhe prishjen e ekuilibrave të gazetarisë në raport me këto zhvillime teknologjike. Një çështje tjetër teorike që do të preket në këtë pjesë është aplikimi i gazetarisë 2.0 dhe shkrimi i gazetarisë klasike dhe kombinimi me atë të formatit të ri. Teoria e radhës të sfondi teorik në këtë kapitull është ajo e metamorfozës. Kjo teori e përdorur shpjegon se media nuk lind në mënyrë spontane dhe të pavarur. Në këtë kapitull janë trajtuar gjithashtu strukturalizmi dhe poststrukturalizmi. Këto dy koncepte teorike, të cilat merren me tekstin gazetaresk dhe strukturën e tij, do të përdoren për t'i sfiduar dhe për të nxjerrë rezultate konkrete se si ka qëndruar dhe se si ka ndryshuar teksti i gazetarisë nga strukturalizmi deri te poststrukturalizmi, pra, nga qëndrueshmëria, e bazuar në rregulla dhe strukturë tekstore, deri te ndryshimi dhe shthurja e tij si rezultat i poststrukturalizmit.

Pa dyshim që njëra nga teoritë kryesore në këtë punim të disertacionit është teoria e zhanrit. Kjo teori, që do të trajtohet në kapitullin e radhës, do të ketë një shtrirje të rëndësishme edhe për faktin se hipoteza kryesore, e cila është në kuadër të rastit studimor, ndërlihet drejtpërdrejt me aspektin e zhanrit. Natyrisht që fokusi kryesor i këtij rasti të studimi do të jetë zhanri informativ, por trajtohen edhe elemente tjera të zhanreve tjera.

Në kapitullin e radhës, atë të katërtin, do të trajtohet konteksti historik i medieeve. Fokusi kryesor në këtë kapitull do të jetë historia e shtypit shqiptar në Kosovë. Ndërlidhja e këtij konteksti ka një rëndësi të madhe për punimin, sepse përmes tij do t'i shohim pikën e zanafillës së shtypit, rrugëtimin e tij, ndryshimin si rrethanë e proceseve politike, ndryshimin e tij si rezultat i zhvillimit teknologjik si dhe transformimin e medieeve digjitale në shekullin e fundit. Në kuadër të këtij kapitulli, pjesa më e rëndësishme e historisë së shtypit është fokusuar te gazeta më jetëgjatë në Kosovë, pra, "Rilindja", e cila kishte lindur pak vite pas Luftës së Dytë Botërore. Megjithatë, janë të cekura edhe revistat dhe gazetat e tjera që kanë lënë gjurmë në historinë e gazetarisë shqiptare, sidomos gjatë viteve të fundit të shekullit të kaluar, të cilat kishin dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në formimin e shtetit të Kosovës.

Në kapitullin e pestë të këtij rasti studimor paraqitet pjesa hulumtuese e studimit. Në këtë pjesë, fillimisht është paraqitur konteksti i rastit studimor, i cili në një formë i argumenton periudhat dhe kompleksitetet në të cilat ka kaluar shtypi, sfidat dhe ndryshimet si dhe shpjegon dhe argumenton se pse kanë ndodhur këto transformime. Në këtë kapitull paraqitet analiza e rastit studimor, ku përmes kombinimit të metodave të ndryshme janë paraqitur të dhëna konkrete shkencore, të bazuara në analizën në qasjen kritike të Shkollës së Frankfurtit. Në analizë përfshihen dy gazeta, “Koha Ditore” dhe “Zëri”, ku autori ka paraqitur gjetje konkrete.

Pas analizimit të teksteve në gazetat “Koha Ditore” dhe “Zëri”, në kapitullin e radhës, atë të gjashtin, është bërë analizë kritike e platformave "online" të këtyre dy gazetave, pra "Koha.net" dhe "Zeri.info". Metodologjia e punës së hulumtimit shkencor, edhe në këtë rast, është bërë pothuajse në mënyrë të ngjashme me format e aplikimit të gazetave. Poashtu, në këtë pjesë prezantohet edhe një hulumtim empirik me gazetarë të medieve "online", të cilët japin përgjigje lidhur me punën e tyre në portale dhe dinamikën e ndryshimit që ka ndodhur, si në aspektin strukturor të lajmit, ashtu edhe në atë përmbajtësor.

Në kapitullin e shtatë të këtij disertacioni të doktoratës, janë prezantuar gjetje konkrete duke u bazuar në metodën kooperative. Në këtë pjesë është bërë një analizim kritik, krahasues në mes të zhanrit tradicional të gazetarisë dhe atij elektronik, të transformuar pas ndryshimeve që kanë ndodhur, kryesisht pas zhvillimit të teknologjisë. Në këtë rast janë paraqitur përfundime konkrete dhe rezultate të cilat kanë qenë edhe hamendësime në kuadër të hipotezave.

Në kapitullin e fundit të këtij studimi janë prezantuar gjetjet konkrete të dala nga ky studim, i cili është shtrirë në tri fusha, atë shkencore, hulumtuese dhe empirike dhe përfundime konkrete.

Në këtë rast studimor, për t'i dhënë përgjigje sa më të prekshme shkencore dhe sa më të argumentuar hulumtuese, është përdorur një metodologji e përzgjedhur, e bazuar në metodat më konkrete, që i japin përgjigje këtij rasti të studimit si: metoda e abstraksionit, metoda e analizës së përmbajtjes, metoda komparative, metoda e sintezës, metoda e konkretizimit, metoda e gjeneralizimit, metoda induktive, metoda deduktive, metoda historike, metoda statistikore, metoda e studimit të rasteve, metoda deskriptive, metoda e analizës së diskut etj.

Objekt i këtij studimi të disertacionit të doktoratës, me titull “Transformimi i zhanrit në mediet online”, do të jenë tekstet e botuara nga mediet "online" (portalet) si "Zëri.info" dhe "Koha.net" si dhe gazetat “Zëri” dhe “Koha Ditore”. Tekstet që do të hulumtohen janë të gazetarisë informative dhe analitike, duke filluar prej aspektit strukturor, përmbajtësor e deri tek ai krahasues. Brenda

këtij objekti të studimit është paraparë që të jenë në fokus të hulumtimit tekstet, duke filluar nga struktura, që do të analizohen titulli, kreu, materiali që e mbështet kreun e deri te sfondi. Gjithashtu, do të analizohen edhe tekstet që nuk i kanë pjesët kryesore në strukturën tekstore.

Qëllimi i punimit është që ta trajtojë transformimin e zhanreve nga ato tradicionale në mediet e reja, përkatësisht nga gazeta e shtypur në gazetën "online". Derisa në gazeta është konsideruar se ishin stabilizuar format e shkrimit të lajmit, te media "online" ka një përmbysje të mënyrës tradicionale të shkrimit të lajmit. Qëllim tjetër në këtë studim do të jetë evoluimi i zhanreve, format me të cilat kanë ndodhur ndryshimet në strukturën e zhanreve e gjithashtu edhe në përmbajtjen e tyre.

Ky rast studimi do t'i ketë në fokus edhe zhvillimet teknologjike, të cilat kanë mundësuar që lajmet të konsumohen shumë më lehtë falë aparaturës së re, si telefonat e mençur, tabletët, etj. Sot, njerëzit kanë më pak kohë të lirë sesa vite më përpara dhe kjo, si duket, ka ndikuar që mediet "online" të prodhojnë përmbajtje mediatike që i përshtatet dinamizmit të jetës, rrjedhimisht, lexuesve të tyre. Megjithëse ka pasur ide se gazetaria do ta prekë fundin e saj për shkak të formave të reja të gazetarisë, së është gazetaria qytetare, në të njëjtën kohë, është rritur kërkesa për lajme të sakta, të verifikuara dhe të filtruara nga redaksitë profesionale të medieve. Prandaj, në një pjesë të studimit, punimi do të përqendrohet në trajtimin dhe ndikimin e evoluimit të zhanreve në saktësinë e lajmit.

Resume

In this doctoral dissertation entitled: "Transformation of the genre in online media", we will address exactly these changes or transformations that have been made in the genre of journalism in the new century. So, through the case study will be researched the changes that have occurred in this field of journalism, specifically in what is known as new journalism. The work in this dissertation will be an original scientific work, based on the latest theories of communication science, research where concrete findings of the case study will be presented and with concrete conclusions and recommendations, giving answers to new problems in science of communication and journalism.

In the second chapter, this doctoral dissertation study will address the theoretical background, which is divided into several scientific fields to reflect and rely as widely as possible on the diversity of communication sciences and journalism. The first scientific part of the theoretical background presents the press theories, because looking at these theories, we will argue in which of them can be analyzed and researched the media that are the object of study. Of course, in this first part of the theoretical background chapter, four press theories are presented: authoritarian theory, soviet communist theory, social responsibility theory, and libertarian theory.

Further in this chapter of the theoretical background will be given importance to the schools of journalism and communication sciences. By looking and analyzing the approach of these schools we will be clearer which of these approaches will be adequate in the case of the study. Therefore, this section includes some of the major schools of journalism and communication, such as the Columbia School approach, the Frankfurt School approach, the Chicago School approach, and the Toronto School approach. In the second part of this first theoretical chapter, the focus will be on the latest theories of new media. These theories are the last word of scientific studies on the challenges and problems faced by the media and their content concerning the demands and spaces of the public. One of the main factors that have influenced the change of the concept of media and theoretical developments is technology. Therefore, a special space will be dedicated to technological development with a focus on advancement and the Internet and the space that the media has used within it, to use it, to distribute, and to communicate with the public and the audience. Thanks to technological changes, the development of the Internet, and the creation of

new media, which many theorists see as just the beginning, the way of journalism has also changed, and its movement from the traditional line.

Part of the paper will be devoted to the concepts of media scholars about the changes and challenges that the development of the Internet has brought to the field of journalism. Here will be provided statistics from around the world, but also from our country for new media, social networks, virtual space that is at the service of the audience, and the disruption of the balance of journalism concerning these technological developments. Another theoretical issue that will be addressed in this section is the application of journalism 2.0, and the merging of classical journalism and the combination with that of the new format. The next theory in the theoretical background used in this chapter is that of metamorphosis. This theory used explains that the media does not arise spontaneously and independently. Structuralism and poststructuralism are also addressed in this chapter. These two theoretical concepts, which deal with the journalistic text and its structure, will be used to challenge, and draw concrete conclusions on how the journalistic text has stood and changed from structuralism to poststructuralism. So, from stability based on rules and textual structure to its change and disintegration because of poststructuralism.

Undoubtedly one of the main theories in this dissertation paper is the theory of genre. This theory will have an important extension for the fact that the main hypothesis which is within the case study is directly related to the genre aspect. Of course, the focus of this case study will be an informative genre, but other elements of other genres are also addressed.

The next chapter, the fourth, will address the historical context of the media. The focus in this chapter will be the history of the Albanian press in Kosovo. The interconnection of this context is of great importance for the work because through it, we will see the starting point of the press, its journey, the change as a circumstance of political processes, its change as a result of technological development, as well as the transformation of digital media in the last century. Within this chapter, the most important part of the history of the press is focused on the longest-running newspaper in Kosovo, Rilindja, which was born a few years after the Second World War. However, some other magazines and newspapers have left traces in the history of Albanian journalism, especially during the last years of the last century, which had made an extraordinary contribution to the formation of the state of Kosovo.

The fifth chapter of this case study presents the research part of the study. This part is initially presented in the context of the case study which in a way argues the periods and complexities in

which the press has gone, challenges and changes, and explains and argues why these transformations have occurred. This chapter presents the analysis of the case study when through a combination of different methods concrete scientific data are presented, based on the analysis in the critical approach of the Frankfurt School. The analysis includes the two newspapers “Koha Ditore” and “Zëri”, where the author has presented concrete findings.

After analyzing the texts in the newspaper “Koha Ditore” and “Zëri”, in the next chapter, the sixth one, a critical analysis of the online platforms of these two newspapers, namely “koha.net” and “zeri.info”. The methodology of scientific research work in this case has become almost like the application forms in newspapers. Also, this part is presented empirical research with online media journalists who give answers about their work on the portal and the dynamics of change that has occurred in both the structural aspect of the news and the content.

In the seventh chapter of this doctoral dissertation, concrete findings are presented based on the comparative method. In this part, a critical, comparative analysis has been made between the traditional genre of journalism and the electronic one, transformed after the changes that have taken place, mainly after the development of technology. In this case, concrete conclusions and results were presented, which were also conjectures within the hypotheses.

The last chapter of this study presents the concrete findings of this study which is extended to three areas, scientific, research, and empirical, and gives concrete conclusions.

In this case, study, to give the most scientific answer and the most argumentative research, a selected methodology was used based on the most concrete methods that answer this case study, such as abstraction method, content analysis, comparative method, synthesis method, concretization method, generalization method, inductive method, deductive method, historical method, statistical method, case study method, descriptive method, desk analysis method, etc.

The object of this study of the doctoral dissertation entitled “Transformation of the genre in online media”, will be the texts published by online media (portals) such as “zeri.info” and “koha.net” as well as the newspapers “Zëri” and “Koha Ditore”. The texts that will be researched are of informative and analytical journalism, starting from the structural aspect, content to the comparative one. Within this object of study, it is foreseen to be in the focus of research the texts starting from the structure, which will be analyzed the title, the chapter, the material that supports the chapter up to the background. Texts that do not have the main parts in the textual structure will also be analyzed.

The study aims to address the transformation of genres from traditional ones to new media, namely from the print newspaper to the online media. While in the newspapers it was considered that the forms of news writing were stabilized, in the online media there is a reversal of the traditional way of writing the news. Another goal in this study will be the evolution of genres, the forms in which changes have occurred in the structure of genres, as well as in their content.

This case study will also focus on technological developments that have enabled news to be consumed much easier thanks to new equipment, such as smartphones, tablets, etc. Today, people have less free time than years ago, and this has apparently influenced online media to produce media content that suits the dynamism of life, and consequently, their readers.

Although there was an idea that journalism would reach its end due to new forms of journalism, such as citizen journalism, at the same time, the demand for accurate news, verified and filtered by professional media outlets has increased. Therefore, in a part of the study, the paper will focus on addressing and the impact of genre evolution on news accuracy.